

TRASHËGIMIA KULTURORE NË

FO KU S.

TRASHËGIMIA KULTURORE NË SHqipëri

TRASHËGIMIA
KULTURORE NË **FO
KU
S.**



BOTIMI I TEKSTEVE BURIMORE
MBI PRAKTIKAT E RUAJTJES DHE
MENAXHIMIT TË TRASHËGIMISË
KULTURORE NË GJUHËN SHQIPE

Titulli: “Trashëgimia Kulturore në Fokus: Botimi i teksteve burimore mbi praktikat e ruajtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore në gjuhën shqipe”

Botimi është mundësuar nga “Trashëgimia Kulturore pa Kufij Shqipëri” (Cultural Heritage without Borders Albania (CHwB Albania) me mbështetjen financiare të Suedisë nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim.

Përkthimet nga origjinali: Të ndryshëm referuar në çdo dokument përkatësisht

Redaktoi: Boiken Abazi

Parathënie për botimin nga: Elena Mamani, Lorenc Bejko dhe Boiken Abazi

Koordinoi procesin e përkthimeve dhe publikimit:

Elena Mamani, Regina Vathi, Pezana Rexha

Foto: © Bjori Thana, Regina Vathi

Dizajni: Ina (Hina) Shkëmbi, Joniz Osmanagaj

© CHwB Albania © ICOMOS Albania

Viti i botimit: 2023

196 f.: me foto ; 21 x 21 cm

ISBN: 9789928801081

1.Pasuria kulturore 2.Ruajtja dhe restaurimi 3.Menaxhimi 4.Shqipëri

904 :72 .03(496.5)

Shtëpia Botuese: “Graphic Line-01”



This work is distributed under the Creative Commons BY-NC-ND 4.0 licence, which enables re-users to copy and distribute the material in any medium or format in non-adapted form only, for non-commercial purposes only, and only so long as attribution is given to the creator.

Ky botim publikohet bazuar në licencën nga “Creative Commons BY-NC-ND 4.0”, e cila u mundëson ripërdoruesve të kopjojnë dhe shpërndajnë materialin në çdo mënyrë komunikimi ose format, por vetëm duke mos kryer përshtatje të formës, duke mos e përdorur për qëllime tregtare, si dhe për aq kohë sa i jepet krijuesit atributi përkatës.

DOKUMENTIMI, PREZANTIMI, DHE INTERPRETIMI | KARTË

KARTA E ICOMOS-IT PËR INTERPRETIMIN DHE PREZANTIMIN E SITEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Përgatitur nën kujdesin e Komitetit Shkencor Ndërkombëtar të ICOMOS-it mbi Interpretimin dhe Prezantimin e Siteve të Trashëgimisë Kulturore. Ratifikuar nga Asambleja e 16-të e Përgjithshme e ICOMOS-it, Québec (Kanada), më 4 tetor 2008.

ICOMOS

Përkthyer nga: Lorenc Bejko.
Redaktuar nga: Boiken Abazi.

Versioni origjinal ©ICOMOS. Ky përkthim nuk është përkthim zyrtar ICOMOS-it. Ky përkthim në gjuhën shqipe botohet me lejen e ICOMOS-it, por nën përgjegjësinë e vetme të përkthyesit/botuesit.

PARATHËNIE

Që nga themelimi i tij në vitin 1965 si një organizatë mbarëbotërore e profesionistëve të trashëgimisë të përkushtuar në studimin, dokumentimin dhe mbrojtjen e siteve të trashëgimisë kulturore, ICOMOS-i është përpjekur të promovojë etikën e konservimit në të gjitha aktivitetet e tij dhe të ndihmojë rritjen e vlerësimit të publikut për trashëgiminë materiale të njerëzimit në të gjitha format dhe larminë e saj.

Siç është shënuar në Kartën e Venecias (1964) "Është e rëndësishme që parimet udhëheqëse për konservimin dhe restaurimin e monumenteve të përcaktohen bashkërisht dhe të formulohen në plan ndërkombëtar, gjithë duke i lënë çdo vendi përkujdesjen për të siguruar zbatimin në kuadrin e kulturës dhe traditave të tij." Kartat e mëvonshme të ICOMOS-it e kanë marrë përsipër këtë mision, duke përcaktuar udhëzime profesionale për sfida specifike të konservimit dhe duke inkurajuar një komunikim efektiv për rëndësinë e konservimit të trashëgimisë në çdo rajon të botës.

Këto karta të mëparshme të ICOMOS-it theksojnë rëndësinë e komunikimit publik si pjesë thelbësore e procesit më të gjerë të konservimit (duke e përshkruar në mënyra të ndryshme si "informim", "popullarizim", "prezantim" dhe "interpretim"). Ato në mënyrë të tërthortë pranojnë se çdo akt i konservimit të trashëgimisë - brenda të gjitha traditave kulturore botërore - është për nga natyra e tij një akt komunikimi.

Nga gama e gjerë e mbetjeve të materialeve të mbijetuara dhe vlerave jomateriale të komuniteteve dhe qytetërimeve të kaluara, përzgjedhja e asaj që do ruhet, si do ruhet dhe si do t'i prezantohen publikut përbëjnë të gjitha elemente të interpretimit të siteve. Ato përfaqësojnë vizionin e çdo brezi për atë që është domethënëse dhe e rëndësishme, si dhe pse mbetjet materiale të së kaluarës duhet t'u barten brezave të ardhshëm.

Nevoja për një arsyetim të qartë, një terminologji të standardizuar dhe parime profesionale të pranura për Interpretimin dhe Prezantimin është evidente. Vitet e fundit, zgjerimi dramatik i veprimtarive interpretuese në shumë site të trashëgimisë kulturore dhe shfaqja e teknikave të rafinuara interpretuese si dhe e strategjive të

reja ekonomike për marketimin dhe menaxhimin e siteve të trashëgimisë kulturore kanë krijuar kompleksitete të reja dhe kanë ngritur pyetje themelore që janë me vlerë qendrore si për konservimin, ashtu edhe për qasjen publike ndaj siteve të trashëgimisë kulturore në të gjithë botën:

- Cilat janë qëllimet e pranura dhe të pranueshme të Interpretimit dhe Prezantimit të siteve të trashëgimisë kulturore?
- Cilat parime duhet të ndihmojnë në përcaktimin se cilat janë teknikat, mjetet dhe metodat më të përshtatshme për kontekste të caktuara të trashëgimisë kulturore?
- Çfarë konsideratash të përgjithshme etike dhe profesionale duhet të ndihmojnë në formësimin e Interpretimit dhe Prezantimit nën dritën e shumëllojshmërisë së formave dhe teknikave të tyre specifike?

Prandaj, qëllimi i kësaj Karte është të përcaktojë parimet bazë të Interpretimit dhe Prezantimit si komponentë thelbësorë të përpjekjeve për konservimin e trashëgimisë dhe si mjet për të rritur vlerësimin dhe kuptimin nga publiku të siteve të trashëgimisë kulturore¹.

PËRKUFIZIMET

Për qëllimet e kësaj Karte,

Interpretimi i referohet gamës së plotë të aktiviteteve të mundshme që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe përmirësimin e të kuptuarit të siteve të trashëgimisë kulturore. Këto mund të përfshijnë botime të shtypura dhe elektronike, leksione publike, instalime brenda sitit ose ato të lidhura drejtpërdrejt me sitin, por jashtë tij, programe arsimore, aktivitete me komunitetin si dhe hulumtime, trajnime dhe vlerësime të vazhdueshme të vetë procesit të interpretimit.

Prezantimi më konkretisht i referohet komunikimit të planifikuar me kujdes të përmbajtjes interpretuese përmes harmonizimit të informacionit interpretues, qasjes fizike dhe infrastrukturës interpretuese në një sit të trashëgimisë kulturore. Ai mund të transmetohet përmes një larmie teknikash, duke përfshirë (por

¹ Megjithëse parimet dhe objektivat e kësaj Karte mund të aplikohen edhe për rastet jashtë siteve, vëmendja e saj kryesore përqendrohet te interpretimi dhe prezantimi në sitet e trashëgimisë kulturore, ose pranë tyre.

jo domosdoshmërisht) elemente të tilla si panele informuese, ekspozime të tipit muzeal, ture itinerarësh të formalizuar, leksione dhe ture me guidë, si dhe aplikacione multimediale dhe faqe interneti.

Infrastruktura interpretuese i referohet instalimeve fizike, objekteve dhe zonave në një sit të trashëgimisë kulturore, ose të lidhura me të, që mund të përdoren posaçërisht për qëllimet e interpretimit dhe prezantimit, duke përfshirë ato interpretime mbështetëse të ofruara nëpërmjet teknologjive të reja apo ekzistuese.

Interpretuesit e siteve janë punonjësit ose vullnetarët e një siti të trashëgimisë kulturore të cilët janë të angazhuar në afatgjatë, ose përkohësisht, në komunikimin publik të informacionit në lidhje me vlerat dhe domethënien e sitit.

Siti i Trashëgimisë Kulturore është vendi, lokaliteti, peizazhi natyror, zona e vendbanimit, kompleksi arkitektonik, siti arkeologjik, ose një strukturë e ruajtur që njihet dhe shpesh mbrohet ligjërisht si një vend me domethënie historike dhe kulturore.

OBJEKTIVAT

Duke pranuar se Interpretimi dhe Prezantimi janë pjesë e procesit të përgjithshëm të konservimit dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore, kjo Kartë synon të identifikojë shtatë parime themelore, mbi të cilat duhet të bazohen Interpretimi dhe Prezantimi – në çfarëdo forme apo mediumi që konsiderohet i përshtatshëm në rrethana specifike.

Parimi 1: Qasja dhe kuptimi.

Parimi 2: Burimet e informacionit.

Parimi 3: Vëmendja ndaj mjedisit rrethues dhe kontekstit.

Parimi 4: Ruajtja e autenticitetit.

Parimi 5: Planifikimi për qëndrueshmëri.

Parimi 6: Shqetësimi për gjithëpërfshirjen.

Parimi 7: Rëndësia e punës kërkimore, trajnimit dhe vlerësimit.

Në vijim të këtyre shtatë parimeve, objektivat e kësaj Karte duhet të:

1. **Lehtësojnë të kuptuarit dhe vlerësimin** e siteve të trashëgimisë kulturore, dhe duhet të nxisin ndërjegjësimin dhe angazhimin e publikut mbi nevojën për mbrojtjen dhe konservimin e tyre.
2. **Komunikojnë kuptimin** e siteve të trashëgimisë

kulturore për një sërë audiencash nëpërmjet dokumentimit dhe identifikimit të kujdesshëm të domethënies, përmes metodave shkencore dhe kërkimore të pranuar, si dhe nga traditat “e gjalla” (ekzistuese) kulturore.

3. **Ruajnë vlerat materiale (të prekshme) dhe jomateriale (të paprekshme)** të siteve të trashëgimisë kulturore në mjediset e tyre natyrore dhe kulturore si dhe në kontekstet e tyre shoqërore.
4. **Respektojnë autenticitetin** e siteve të trashëgimisë kulturore, duke komunikuar domethënien e strukturës së tyre historike dhe të vlerave kulturore, dhe duke i mbrojtur ato nga ndikimi negativ ndërhyrës i infrastrukturës interpretuese, nga trysnia që ushtrohet prej vizitorëve, ose nga interpretimi i pasaktë apo i papërshtatshëm.
5. **Kontribuojnë në konservimin e qëndrueshëm** të siteve të trashëgimisë kulturore nëpërmjet promovimit të të kuptuarit publik dhe të pjesëmarrjes në përpjekjet e vazhdueshme konservuese, duke siguruar mirëmbajtje afatgjatë të infrastrukturës interpretuese dhe rishikim të rregullt të përmbajtjes interpretuese.
6. **Inkurajojnë gjithëpërfshirjen** në interpretimin e siteve të trashëgimisë kulturore, duke lehtësuar përfshirjen e palëve të interesit dhe komuniteteve të lidhura me zhvillimin dhe zbatimin e programeve të interpretimit.
7. **Formulojnë udhëzime teknike dhe profesionale** për interpretimin dhe prezantimin e trashëgimisë, duke përfshirë teknologji, punë kërkimore dhe trajnime. Udhëzime të tilla duhet të jenë të përshtatshme dhe të qëndrueshme në kontekstet e tyre shoqërore.

PARIMET

Parimi 1: Qasja dhe kuptimi

Programet e interpretimit dhe prezantimit duhet lehtësojnë qasjen fizike dhe intelektuale të publikut në sitet e trashëgimisë kulturore.

1. Interpretimi dhe prezantimi efektiv duhet të pasurojnë përvojën personale, të shtojnë respektin dhe kuptimin nga ana e publikut, dhe të komunikojnë rëndësinë e konservimit të siteve të trashëgimisë kulturore.

2. Interpretimi dhe prezantimi duhet të inkurajojnë individët dhe komunitetet të reflektojnë mbi perceptimet e tyre për sitin dhe t'i ndihmojnë ata në krijimin e një lidhje kuptimplotë me të. Qëllimi duhet të jetë stimulimi i mëtejshëm i interesit, nxënies, përvojës dhe eksplorimit.
3. Programet e interpretimit dhe prezantimit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë audiencën e tyre demografikisht dhe kulturalisht. Duhet bërë të gjitha përpjekjet për të komunikuar vlerat dhe domethënien e sitit tek audiencia të ndryshme.
4. Në krijimin e infrastrukturës interpretuese duhet marrë parasysh larmia e gjuhëve të vizitorëve dhe e komuniteteve të lidhura me një sit të trashëgimisë.
5. Aktivitetet e interpretimit dhe prezantimit duhet gjithashtu të jenë fizikisht të qasshme për një publik të larmishëm.
6. Interpretimi dhe prezantimi duhet të ofrohen jashtë sitit në rastet kur qasja fizike në një sit të trashëgimisë kulturore është e kufizuar për shkak të shqetësimeve që lidhen me konservimin, ndjeshmërinë kulturore, ripërdorimin e përshtatur apo për arsye sigurie.

Parimi 2: Burimet e informacionit

Interpretimi dhe prezantimi duhet të bazohen në dëshmi të përftuara nëpërmjet metodave shkencore dhe kërkimore të pranuar, sikurse edhe nga traditat "e gjalla" (ekzistuese) kulturore.

1. Interpretimi duhet të tregojë gamën e gjerë të informacioneve gojore dhe të shkruara, mbetjet materiale, traditat dhe kuptimet që i atribuohen një siti. Burimet e këtij informacioni duhet të dokumentohen, arkivohen dhe të vendosen në dispozicion për publikun.
2. Interpretimi duhet të bazohet mbi një studim të mirë hulumtues dhe shumëdisiplinor të sitit dhe rrethinave të tij. Interpretimi duhet të pranojë gjithashtu se interpretimet e vlefshme kanë nevojë të përfshijnë reflektime mbi hipoteza alternative historike, traditat dhe historitë lokale.
3. Në sitet e trashëgimisë kulturore ku tregimet tradicionale ose kujtimet e pjesëmarrësve historikë ofrojnë burime të rëndësishme informacioni për domethënien e sitit, programet interpretuese duhet t'i përfshijnë këto dëshmi gojore – ose në mënyrë

indirekte, nëpërmjet elementeve të infrastrukturës interpretuese; ose drejtpërdrejt, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të anëtarëve të komuniteteve përkatëse si interpretues të sitit.

4. Rindërtimet vizuale (pamore), qofshin nga artistë, arkitektë, ose modelues kompjuterikë, duhet të bazohen në analiza të detajuara dhe sistematike të të dhënave mjedisore, arkeologjike, arkitekturore dhe historike, duke përfshirë analizat e burimeve të shkruara, gojore, ikonografike, si dhe fotografitë. Burimet e informacionit mbi të cilat bazohen krijime të tilla vizuale duhet të dokumentohen në mënyrë të qartë, dhe aty ku është e mundur duhet të paraqiten rindërtime alternative bazuar në të njëjtat të dhëna për të bërë krahasimin.
5. Programet dhe aktivitetet e interpretimit dhe prezantimit duhet gjithashtu të dokumentohen dhe arkivohen për referencë dhe reflektim në të ardhmen.

Parimi 3: Konteksti dhe mjedisi rrethues

Interpretimi dhe prezantimi i siteve të trashëgimisë kulturore duhet të lidhen me kontekstet dhe mjediset e tyre më të gjera sociale, kulturore, historike dhe natyrore.

1. Interpretimi duhet të hulumtojë domethënien e një siti në kontekstet e tij të shumanshme historike, politike, shpirtërore dhe artistike. Ai duhet të marrë parasysh të gjitha aspektet e domethënies dhe vlerave kulturore, sociale dhe mjedisore të sitit.
2. Interpretimi publik i një siti të trashëgimisë kulturore duhet të dallojë qartë dhe të datojë fazat e njëpasnjëshme dhe ndikimet në evoluimin e tij. Duhet respektuar kontributet e të gjitha periudhave në domethënien e një siti.
3. Interpretimi gjithashtu duhet të marrë parasysh të gjitha grupet që kanë kontribuar në domethënien historike dhe kulturore të sitit.
4. Peizazhi përreth, mjedisi natyror, dhe vendndodhja gjeografike janë pjesë përbërëse e domethënies historike dhe kulturore të një siti, dhe, si të tilla, duhen marrë parasysh në interpretimin e tij.
5. Në interpretimin e sitit duhen marrë parasysh elementet jomateriale të trashëgimisë së tij, si p.sh. traditat kulturore dhe shpirtërore, tregimet, muzika, vallet, teatri, letërsia, artet pamore, zakonet lokale

dhe trashëgimia në gatime.

6. Në formulimin e programeve interpretuese duhet të merren parasysh rëndësia ndërkulturore e siteve të trashëgimisë, si dhe gama e gjerë e këndvështrimeve rreth tyre të bazuara mbi kërkime shkencore, të dhënat nga lashtësia dhe traditat “e gjalla” (ekzistuese).

Parimi 4: Autenticiteti

Interpretimi dhe prezantimi i siteve të trashëgimisë kulturore duhet të respektojnë parimet bazë të autenticitetit në frymën e Dokumentit të Narës (1994).

1. Autenticiteti është një shqetësim që lidhet me komunitetin njerëzor dhe me mbetjet materiale. Konceptimi i një programi interpretues të trashëgimisë duhet të respektojë funksionet tradicionale shoqërore të sitit si dhe praktikat kulturore dhe dinjitetin e banorëve vendas dhe komuniteteve të lidhura me të.
2. Interpretimi dhe prezantimi duhet të kontribuojnë në ruajtjen e autenticitetit të një siti të trashëgimisë kulturore duke komunikuar rëndësinë e tij, pa ndikuar negativisht në vlerat e tij kulturore dhe pa ndryshuar në mënyrë të pakthyeshme strukturën e tij.
3. Të gjitha infrastrukturat e dukshme interpretuese (siç janë kioskat, shtigjet e ecjes dhe panelet shpjeguese) duhet të jenë të ndjeshme ndaj karakterit, mjedisit rrethues dhe domethënies kulturore dhe natyrore të sitit, duke mbetur lehtësisht të identifikueshme.
4. Koncertet, shfaqjet teatrale dhe programe të tjera interpretuese në sit duhet të planifikohen me kujdes, në mënyrë që të mbrojnë domethënien dhe mjedisin rrethues të sitit, si dhe për të minimizuar shqetësimin e banorëve vendas.

Parimi 5: Qëndrueshmëria

Plani i interpretimit për një sit të trashëgimisë kulturore duhet të jetë i ndjeshëm ndaj mjedisit të tij natyror dhe kulturor, duke patur si qëllime kryesore qëndrueshmërinë sociale, financiare dhe mjedisore.

1. Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të interpretimit dhe prezantimit duhet të jetë pjesë përbërëse e planifikimit të përgjithshëm, buxhetimit dhe procesit të menaxhimit të siteve të trashëgimisë kulturore.

2. Në studimet e vlerësimit të ndikimit mbi trashëgiminë duhet të merren krejtësisht parasysh efektet e mundshme nga infrastruktura interpretuese dhe nga numri e vizitorëve mbi vlerën kulturore, karakteristikat fizike, integritetin dhe mjedisin natyror të sitit.
3. Interpretimi dhe prezantimi duhet t'i shërbejnë një numri të madh objektivash konservuese, edukuese dhe kulturore. Sukseset e një programi interpretimi nuk duhet të vlerësohet vetëm mbi bazën e shifrave të numrit të vizitorëve ose të të ardhurave.
4. Interpretimi dhe prezantimi duhet të jenë pjesë përbërëse e procesit të konservimit, duke rritur ndërgjegjësimin e publikut për problemet specifike të konservimit që hasen në një sit dhe duke shpjeguar përpjekjet që bëhen për të mbrojtur integritetin fizik dhe autenticitetin e sitit.
5. Çdo element teknik ose teknologjik që përzgjidhet për t'u bërë pjesë e përhershme e infrastrukturës interpretuese të një siti duhet të projektohet dhe ndërtohet në një mënyrë që siguron mirëmbajtje të rregullt dhe efektive.
6. Programet interpretuese duhet të synojnë të ofrojnë përfitime të barabarta dhe të qëndrueshme ekonomike, sociale dhe kulturore për të gjitha palët e interesit nëpërmjet mundësive për edukim, trajnim dhe punësim në programet e interpretimit të sitit.

Parimi 6: Gjithëpërfshirja

Interpretimi dhe prezantimi i siteve të trashëgimisë kulturore duhet të jenë rezultat i një bashkëpunimi kuptimplotë ndërmjet profesionistëve të trashëgimisë, komuniteteve vendase dhe atyre që lidhen me sitin, si dhe palët e tjera të interesit.

1. Në formulimin e programeve të interpretimit dhe prezantimit të sitit duhet të integrohet ekspertiza shumëdisiplinore e studiuesve, anëtarëve të komunitetit, ekspertëve të konservimit, autoriteteve qeverisëse, administratorëve dhe interpretuesve të sitit, operatorëve turistikë dhe profesionistëve të tjerë.
2. Të drejtat zakonore, përgjegjësitë dhe interesat e pronarëve, vendasve dhe komuniteteve që kanë lidhje me sitin duhet të identifikohen dhe respektohen qysh në planifikimin e programeve të interpretimit dhe prezantimit të sitit.

3. Planet për zgjerimin apo rishikimin e programeve të interpretimit dhe prezantimit duhet të jenë të hapura për komente dhe përfshirje publike. Është e drejta dhe përgjegjësia e të gjithëve për t'i bërë të njohura opinionet dhe këndvështrimet e tyre.
4. Meqenëse çështjet e pronësisë intelektuale dhe e të drejtave zakonore kulturore janë veçanërisht të rëndësishme për procesin e interpretimit dhe pasqyrimin e tij përmes medimeve të ndryshme të komunikimit (si prezantimet multimediale në sit, media digjitale dhe materiale të shtypura), pronësia ligjore dhe e drejta e përdorimit të imazheve, teksteve dhe materialeve të tjera interpretuese duhen diskutuar, sqaruar dhe duhet rënë dakord mbi to qysh në procesin e planifikimit.

Parimi 7: Puna kërkimore, trajnimi dhe vlerësimi

Puna kërkimore, trajnimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm janë komponentë thelbësorë të interpretimit të një siti të trashëgimisë kulturore.

1. Interpretimi i një siti të trashëgimisë kulturore nuk duhet të konsiderohet i përfunduar me kompletimin e një infrastrukture specifike interpretuese. Për thellimin e kuptimit dhe vlerësimit të mëtejshëm të sitit mbetet e rëndësishme puna kërkimore dhe konsultimi i vazhdueshëm. Rishikimi i rregullt duhet të jetë një element i pandashëm i çdo programi që interpreton trashëgiminë.
2. Programi dhe infrastruktura interpretuese duhet të projektohen dhe ndërtohen në një mënyrë të tillë që mundëson rishikimin dhe/ose zgjerimin e vazhdueshëm të përmbajtjes.
3. Programet e interpretimit dhe prezantimit dhe ndikimi i tyre fizik mbi sitin duhet të monitorohen dhe vlerësohen vazhdimisht, si dhe duhen bërë ndryshime periodike në bazë të analizave shkencore dhe akademike, si dhe bazuar mbi komentet nga publiku. Vizitorët dhe anëtarët e komuniteteve të lidhura me sitin, si dhe profesionistët e trashëgimisë duhet të përfshihen në këtë proces vlerësimi.
4. Çdo program interpretimi duhet të konsiderohet si një burim edukimi për njerëzit e të gjitha moshave. Projektimi duhet të marrë parasysh mundësinë e përdorimit të tij në kurrikulat shkollore, në programet informale, në të mësuarit e vazhdueshëm përgjatë jetës, në mediat e komunikimit dhe informimit, në aktivitetet e veçanta, si dhe në ngjarjet dhe angazhimin sezonal të vullnetarëve.
5. Një objektiv vendimtar mbetet trajnimi i profesionistëve të kualifikuar në fusha të specializuara të interpretimit dhe prezantimit të trashëgimisë, si në krijimin e përmbajtjes, në administrimin dhe teknologjinë, si dhe në guida dhe në arsim. Përveç kësaj, programet bazë akademike për konservimin duhet të përfshijnë një komponent për interpretimin dhe prezantimin në kurset e tyre të studimit.
6. Kurse dhe programe trajnimi për zhvillimet më të fundit dhe risitë në këtë fushë duhen zhvilluar në sit me qëllim përditësimin dhe informimin e punonjësve të trashëgimisë dhe interpretimit të të gjitha niveleve, si dhe për komunitetet vendase dhe ato që janë të lidhura me sitin.
7. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe këmbimi i përvojës janë thelbësore për zhvillimin dhe ruajtjen e standardeve në metodat dhe teknologjitë e interpretimit. Për këtë qëllim, duhet të inkurajohen konferenca ndërkombëtare, seminare dhe shkëmbimet e punonjësve profesionalë, si dhe takimet kombëtare dhe rajonale. Këto do të ofrojnë një mundësi për ndarjen e rregullt të informacionit mbi larinë e përfaqësive dhe përvojave interpretuese në rajone dhe kontekste kulturore të ndryshme.